

VNR SI NJË
PRAKTIKË E
MIRË

-

LIGJI PËR
NDËRMARRJET
PUBLIKE

-

DHEJTOR, 2019



VNR SI NJË PRAKTIKË E MIRË

-

LIGJI PËR NDËRMARRJET PUBLIKE

-

DHJETOR, 2019

Botues: Institutit për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup
Qendra për Analiza Ekonomike (CEA)

Përkthim: Litra

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

Ky publikim është i disponueshëm në:

<https://idsos.org.mk/mk/portfolio/propozim-raport-per-vleresimin-e-ndikimit-te-rregullatives/>

Disklejmër

Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të Unionit Evropian, në kuadër të projektit Vlerësimi i ndikësës së rregullativës nën hije: Promovimi i krijimit të politikave të bazuara në dëshmi. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas Civilis” dhe e “Qendrës për analiza ekonomike” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të llogaritet se i reflekton pikëpamjet e Unionit Evropian.

EMËRTIMI I MINISTRISË:

Ministria e Ekonomisë

EMËRTIMI I PROPOZIM LIGJIT:

Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për
Ndërmarrjet Publike

OBLIGIMI PËR PËRGATITJEN E PROPOZIM LIGJIT DEL NGA:

Programi Vjetor për Punë i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë
Strategjia për Reforma në Administratën Publike 2018-2022

LIDHJA ME DIREKTIVAT E BE-SË

/

**A PËRMBAN DRAFT-RAPORTI INFORMACIONE NË PËRPTHJE
ME DISPOZITAT TË CILAT KANË TË BËJNË ME INFORMACIONET E
KLASIFIKUARA**

Jo

**DATA E DEPOZITIMIT TË DRAFT RAPORTIT PRANË MINISTRISË PËR
SHOQËRI INFORMATIKE DHE ADMINISTRATË:**

/

**DATA E MARRJES SË MENDIMIT NGA MINISTRIA PËR SHOQËRI INFOR-
MATIKE DHE ADMINISTRATË**

/

1. PËRSHKRIMI I GJENDJES NË FUSHËN PËRKATËSE DHE PËRCAKTIMI I PROBLEMIT

1.1. PËRSHKRIMI I GJENDJES

Ndërmarrjet Publike janë rregulluar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 38/96, 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16 dhe 64/18).

Ndërmarrjet Publike themelohen për shkak të kryerjes së veprimtarive me interes publik. Ndërmarrje Publike në emër të Republikës së Maqedonisë themelon Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në emër të komunës, këshillit të komunës dhe në emër të Qytetit të Shkupit, Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Organe të ndërmarrjeve publike janë:

- Këshilli Drejtues,
- Drejtori dhe
- Këshilli Mbikëqyrës.

Këshilli Drejtues i ndërmarrjes publike përbëhet prej më së paku pesë, dhe më së shumti 15 anëtarë. Në Këshillin Drejtues themeluesi emërton, pikërisht shkarkon përfaqësues nga radhët e ekspertëve të afirmuar dhe të njohur në domenin e lëndës së punës të ndërmarrjes publike duke pasur parasysh përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të përfaqësuesve të të gjitha komuniteteve.

Për kryetar dhe anëtar të Këshillit Drejtues mund të emërohet person i cili plotëson kushtet e mëposhtme:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- ka fituar të paktën 240 kredi sipas EKTC-së ose ka përfunduar shkallën VII/1 të arsimit,

- ▶
 - në momentin e emërimit me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion kundërvajtjeje ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë apo detyrës dhe
 - ka minimum tre vjet eksperiencë pune.

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues nuk mund të jetë më e gjatë se katër vjet.

Me punën e ndërmarrjes publike udhëheq drejtori, që zgjidhet, pikërisht shkarkohet nga Këshilli Drejtues. Drejtori i ndërmarrjes publike mund të caktojë të punësuar, i cili në mungesë të tij e zëvendëson dhe drejton ndërmarrjen publike. Drejtori zgjidhet me mandat katër vjeçar. Me punën e ndërmarrjes publike, të themeluar nga komuna, përkatësisht Qyteti i Shkupit, udhëheq drejtori të cilin e zgjedh, përkatësisht e shkarkon kryetari i komunës, përkatësisht Qyteti i Shkupit. Për emërimin e drejtorit shpallet thirrje publike në tre gazeta ditore, të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat në njërin nga gazetatat që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Për drejtor mund të emërohet person i cili plotëson kushtet e mëposhtme:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- ka fituar të paktën 240 kredi sipas EKTC-së ose ka përfunduar shkallën VII/1 të arsimit,
- në momentin e emërimit me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion kundërvajtjeje ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë apo detyrës dhe ka minimum pesë vjet eksperiencë pune,
- posedon një nga certifikatat e njohura ndërkombëtare ose certifikatë për njohjen aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet si më poshtë: TOEFL IBT – më së paku 74 pikë, IELTS - më së paku 6 pikë, ILEC Cambridge English: Legal - më së paku nivelin B2, FCE Cambridge English: First) – të përfunduar, BULATS - më së paku 60 pikë ose APTIS - më së paku nivelin B2.

Drejtori është i obliguar çdo gjashtë muaj të depozitojë raport për punën e ndërmarrjes publike pranë Këshillit Drejtues, përkatësisht kryetarit të komunës, përkatësisht kryetarit të Qytetit të Shkupit. Në raport, drejtori është i obliguar në mënyrë të veçantë të depozitojë të dhëna për llojin dhe volumin e punëve të kryera gjatë kryerjes së veprimtarisë së ndërmarrjes publike, si dhe të dhëna për punën financiare. Nëse në raportin për punë konstatohen mangësi dhe/ose humbje në punën financiare, drejtori është i obliguar të njëjtat t'i mënjanojë në gjashtë muajt e ardhshëm. Drejtori është i obliguar të shpallë raportin tremujor i cili përmban tregues për punën financiare, llogarinë vjetore dhe raportin për punë të ndërmarrjes publike në ueb-faqen e ndërmarrjes publike.

Drejtori i ndërmarrjes publike shkarkohet para skadimit të mandatit, në kushtet e mëposhtme:

- me kërkesën e tij,
- nëse shfaqet ndonjë nga arsyet, për shkak të të cilave sipas dispozitave për marrëdhënie pune ndërpriten marrëdhëniet e punës në përputhje me ligjin,
- nëse nuk punon dhe vepron sipas ligjit, statutit dhe akteve të ndërmarrjes publike ose në mënyrë të padrejtë nuk i zbaton vendimet e Këshillit Drejtues ose vepron në kundërshtim me to,
- nëse me punën e tij të pandërgjegjshme i shkakton dëm ndërmarrjes publike,
- nëse shpërfill ose nuk realizon obligimet dhe me këtë do të shfaqen shkelje në kryerjen e veprimtarisë me interes publik të ndërmarrjes publike,
- nëse nuk depoziton raportin për punë,
- nëse edhe pas kalimit të afatit prej gjashtë muajsh nuk ka eliminuar mangësitë ose në atë afat përsëri ka mangësi dhe/ose humbje në punën financiare dhe
- nëse pas skadimit të afatit prej 20 ditësh nga përfundimi i tremujorit nuk ka depozituar pranë themeluesit raport për punë me tregues financiarë ose në një afat prej 15 ditësh nga dita e depozitimit të llogarisë vjetore pranë Regjistrisë Qendrore nuk shpall në ueb-faqen e ndërmarrjes publike raportin



- ▶ tremujor, i cili përmban tregues për punën financiare, llogarinë vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike.

Këshilli Drejtues, përkatësisht kryetari i komunës, përkatësisht kryetari i Qytetit të Shkupit, nëse nuk është plotësuar një nga kushtet paraprake do të sjellë vendim për shkarkimin e drejtorit. Deri në zgjedhjen e drejtorit të ri, Këshilli Drejtues, përkatësisht kryetari i komunës, përkatësisht kryetari i Qytetit të Shkupit në një afat prej pesë ditësh nga dita e sjelljes së vendimit për shkarkimin e drejtorit, emëron ushtrues të detyrës drejtor i ndërmarrjes publike, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

Për kryerjen e kontrollit të punës materialo-financiare të ndërmarrjes publike formohet Këshilli Mbikëqyrës për Kontrollin e Punës Materialo-Financiare (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli Mbikëqyrës) me pesë anëtarë. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jetë më e gjatë se katër vjet. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës i emëron, përkatësisht i shkarkon themeluesi.

Për anëtar të këshillit mbikëqyrës mund të emërohet person i cili plotëson kushtet e mëposhtme:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- ka fituar të paktën 240 kredi sipas EKTC-së ose ka përfunduar shkallën VII/1 të arsimit,
- në momentin e emërimit me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtjeje ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë apo detyrës dhe
- has a minimum of three years working experience.

Për shkak të kryerjes së punëve për kontrollin e punës Këshilli Mbikëqyrës për kontroll mund të kryejë kontrollin në vend të të gjitha dokumenteve dhe shkresave të ndërmarrjes publike. Këshilli Mbikëqyrës për kontroll mundet për shkak të kontrollit të dokumenteve dhe shkresave të ndërmarrjes publike të thërrasë ekspertë të cilët do të ndihmojnë në zgjidhjen e mbikëqyrjes. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për kontroll mund të marrin pjesë në seancën e Këshillit Drejtues dhe u dërgohet ftesë me të gjitha materialet që u dërgohen anëtarëve të Këshillit Drejtues. Këshilli Mbikëqyrës për kontroll është i obliguar t'i shqyrtojë raportet tremujore të cilat përmbajnë tregues për punën financiare, llogaritë vjetore dhe raportin për punë të

ndërmarrjes publike dhe pas shqyrtimit i jep mendim Këshillit Drejtues. Këshilli Drejtues nuk mund t'i miratojë raportet tremujore të cilat përmbajnë tregues për punën financiare, llogaritë vjetore dhe raportin për punën të ndërmarrjes publike, nëse nuk ka marrë paraprakisht mendim pozitiv nga Këshilli Mbikëqyrës. Këshilli Mbikëqyrës për kontroll mund të aprovojë aktet e sjella nga Këshilli Drejtues, nëse ajo është përcaktuar me statutin e ndërmarrjes publike. Raportin për shqyrtimin e llogarive vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike me mendimin e vet, Këshilli Mbikëqyrës për kontroll ia dërgon ministrit të financave. Në raportin pranë ministrit të financave, Këshilli Mbikëqyrës për kontroll njofton për gjendjen e ndërmarrjes publike mbi punën e së cilës kryhet kontrolli. Këshilli Mbikëqyrës për kontroll i dërgon kopje të raportit edhe ministrit kompetent për punën e veprimtarisë përkatëse. Këshilli Mbikëqyrës në mënyrë të detyrueshme mban takime të paktën katër herë në vit.

Ligji për Ndërmarrjet Publike rregullon punën dhe veprimtarinë e ndërmarrjes publike. Ligji përmban kushte për emërimin e anëtarëve të këshillave drejtues, drejtorëve dhe anëtarëve të këshillave mbikëqyrës. Megjithatë këto kushte janë shumë të përgjithshme, dhe nuk janë të lidhura me vetë kompetencën e ndërmarrjes publike. Numri i anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës nuk është adekuat me nevojat reale të ndërmarrjeve publike. Kështu numri i anëtarëve është shumë i madh, dhe duke pasur parasysh se këto organe drejtuese dhe mbikëqyrëse në ndërmarrjet publike kanë kompetencë të përcaktuar ligjore, e cila është profesionale, numri i madh i anëtarëve vështirëson punën e përgjithshme dhe funksionimin e organeve. Në lidhje me emërimin e këtyre personave, mungon procedura sipas meritave, përkatësisht nuk është rregulluar procedura për zgjedhjen e kandidatit më të mirë, në rastin kur ka më shumë kandidatë për një pozicion. Në lidhje me shkarkimin, ligji përmban kushte vetëm për shkarkimin e drejtorëve të ndërmarrjeve publike, por jo edhe të anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës. Ligji përmban dispozita të qarta për kontrollin e rregullt të punës së përgjithshme financiare të ndërmarrjes publike nga ana e Këshillit Mbikëqyrës. Kjo do të thotë se anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të njohin shumë mirë punën e ndërmarrjes publike si dhe të gjitha dispozitat të cilat kanë të bëjnë me punën e ndërmarrjeve publike, dhe nga ana tjetër ligji nuk përcakton kushte të qarta për kualifikime të tilla të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës. Me këtë në praktikë është e pamundur, këto anëtarë të kryejnë kontroll adekuat.

1.2 SHKAQE PËR PROBLEMET TË CILAT JANË LËNDË E SHQYRTIMIT

Gjendja e lartpërmendur në fushën të cilën rregullon ky ligj është rezultat i shkaqeve të mëposhtme:

- kushtet për emërimin e drejtorëve, anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës në ndërmarrjet publike janë shumë të përgjithshme, dhe nuk janë të lidhura me vetë kompetencat e ndërmarrjes publike;
- numri i anëtarëve të këshillave drejtues dhe këshillave mbikëqyrëse është shumë i madh dhe nuk korrespondon me nevojat reale, por edhe me mundësitë financiare të ndërmarrjeve publike;
- kompetencat e drejtorit, si dhe të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës kërkojnë shkallë të lartë profesionalizmi nga ana e tyre, para së gjithash në fushat e veprimtarisë së ndërmarrjes publike, punës materialo-financiare, menaxhimit me burimet njerëzore, çështjeve juridike etj.
- mungon procedura sipas meritave për seleksionimin e kandidatëve për anëtarë të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës, përkatësisht nuk është rregulluar procedura për zgjedhjen e kandidatit më të mirë, në rastet kur ka më shumë se një kandidat për një pozicion;
- ligji nuk përmban asnjë lloj kushti për shkarkimin e anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës, por vetëm kushte formale për shkarkimin e drejtorëve, të cilat nuk janë të lidhura me cilësinë e punës së ndërmarrjes publike. Me këtë nuk ka asnjë mekanizëm përgjegjësie të drejtorëve, por edhe të anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës për cilësinë e punës së tyre, prandaj edhe puna e vetë ndërmarrjeve publike dhe cilësia e shërbimeve që u ofrojnë qytetarëve është pa asnjë kontroll

2. QËLLIME TË PROPOZIM-RREGULLORES

Qëllimi i këtyre ndryshimeve të Ligjit për Ndërmarrjet Publike është që të vendoset procedura sipas meritave për seleksionimin dhe emërimin e drejtorit, anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës në ndërmarrjet publike. Në mënyrë plotësuese ligji përcakton edhe kushte për shkarkimin e drejtorëve të ndërmarrjeve publike, fuqizon kriteret për anëtarë të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës, zvogëlon numrin e anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës, si dhe përcakton profilin e personave të cilët mund të jenë anëtarë të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës.

3. ZGJIDHJE TË MUNDSHME (OPSIONE)

3.1 PËRSHKRIMI I ZGJIDHJES „MOS BËJ ASGJË“

Opsioni “mos bëj asgjë” përdoret si parametër për krahasimin e shpenzimeve dhe përfitimeve nga opsionet e tjera (baseline).

Kjo zgjidhje nënkupton që të mos sillen ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Në një rast të tillë problemet në lidhje me funksionimin e ndërmarrjes publike do të mbeten edhe më tej, përkatësisht numri i anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës do të jetë shumë i madh dhe jo adekuat me nevojat dhe mundësitë e ndërmarrjeve publike. Nuk do të ketë kushte për anëtarë të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës të cilat do të jenë në përputhje me kompetencat e këtyre organeve, që do të thotë se këto organe edhe në të ardhmen nuk do të mund t'i realizojnë kompetencat e tyre ligjore. Mungesa e procedurës së hapur, të drejtë, transparente dhe sipas meritave për seleksionimin e kandidatëve për anëtarë të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës do të mundësojë edhe në të ardhmen në këto organe të emërohen persona mbi bazën e një vendimi politik diskret, dhe jo mbi bazën e kompetencave, që lë hapësirë për veprimtari korrupsioni. Mungesa e kushteve dhe bazave ligjore për shkarkimin e anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës, veçanërisht të lidhura me cilësinë e punës së tyre, do të thotë se edhe në të ardhmen, personat e angazhuar në këto organe nuk do të kenë asnjë përgjegjësi për punën e tyre.

3.2 PËRSHKRIMI I ZGJIDHJEVE TË MUNDSHME (OPSIONEVE) PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT

Sjellja e Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Me Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike do të:

- Kryhet klasifikimi i ndërmarrjeve publike në ndërmarrje mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha, dhe kjo në varësi të numrit të punëtorëve, të ardhurave vjetore, si dhe numrit të qytetarëve të cilëve ato duhet t'u ofrojnë shërbime.
- Në varësi të madhësisë së ndërmarrjeve publike do të përcaktohet edhe numri i anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës. Kështu në ndërmarrjet publike mikro dhe të vogla Këshilli Drejtues do të ketë pesë anëtarë, ndërsa në ndërmarrjet publike të mesme dhe të mëdha shtatë anëtarë. Ky është një racionalizim i madh sepse ligji ekzistues jep mundësi këshillat drejtues të ndërmarrjeve publike të kenë deri në 15 anëtarë, ku nuk ka asnjë lloj kriteri të qartë se si do të përcaktohet ky numër. Nga ana tjetër këshillat mbikëqyrës në ndërmarrjet publike mikro dhe të vogla janë hequr, përkatësisht mbikëqyrja do të realizohet nëpërmjet revizorëve, në përputhje me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik, përderisa në ndërmarrjet publike të mesme dhe të mëdha numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrës do të jetë tre, që gjithashtu është zvogëlim në lidhje me zgjidhjen e tanishme ligjore.
- Do të vendosen kushte të qarta dhe konkrete për emërimin e drejtorëve të ndërmarrjeve publike të themeluara nga ana e komunave (ndërmarrjet shtetërore publike janë përfshirë me Ligjin për Shërbimin e Lartë Drejtues), anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës të cilët do të jenë në lidhje të drejtpërdrejtë me

- ▶ kompetencat e këtyre organeve të ndërmarrjeve publike. Kështu për drejtor përveç kushteve të përgjithshme të ligjit, të cilat kanë të bëjnë me shkallën e arsimit, shtetësinë, mos dënimit dhe eksperiencës drejtuese, do të vlejné edhe kompetenca të veçanta të cilat do t'i përcaktojë Këshilli për Seleksionim. Në lidhje me anëtarët e Këshillit Drejtues, përveç kushteve të përgjithshme, të cilat kanë të bëjnë me drejtorët, janë parashikuar edhe kushte plotësuese, kushte të veçanta, ku një pjesë e anëtarëve të këshillave drejtues duhet të kenë të paktën pesë vjet eksperiencë pune në fushën e veprimtarisë së ndërmarrjes publike ose në veprimtari të ngjashme, dhe në përputhje me Klasifikimin Kombëtar të Veprimtarive të Entit Shtetëror për Statistikë një pjesë e anëtarëve të Këshillit Drejtues duhet të kenë të paktën pesë vjet eksperiencë pune, nga të cilat tre vjet eksperiencë në pozicion drejtues ose drejtim me ekip dhe një pjesë e anëtarëve të Këshillit Drejtues duhet të kenë të paktën pesë vjet eksperiencë pune, nga të cilat të paktën tre vjet eksperiencë me drejtimin financiar. Zgjidhje e ngjashme propozohet edhe për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, i cili do të ekzistojë vetëm në ndërmarrjet publike të mesme dhe të mëdha në të cilat një anëtar duhet të jetë ekonomist i diplomuar me pesë vjet eksperiencë pune në revizion, një anëtar duhet të jetë jurist i diplomuar me pesë vjet eksperiencë pune në çështje juridike dhe përshtatje juridike dhe një anëtar duhet të jetë me arsim përkatës në fushën e veprimtarisë së ndërmarrjes publike në përputhje me Klasifikimin Kombëtar të Veprimtarive të Entit Shtetëror për Statistikë. Një strukturë e tillë e këshillave drejtues dhe mbikëqyrës do të garantojë cilësi në realizimin e kompetencave të këtyre organeve drejtuese dhe kontrolli.
- Me vendosjen e procedurës sipas meritave për seleksionimin e kandidatëve për drejtor (në ndërmarrjet publike të themeluara

nga komunitat), anëtarë të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës, do të rregullohet procedura për zgjedhjen e kandidatit më të mirë, në rastet kur ka më shumë se një kandidat për një pozicion. Përkisht propozohet që për zgjedhjen anëtarë të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës të ndërmarrjes publike të shpallet thirrje publike, në ueb- faqen e themeluesit, në ueb-faqen e Agjencisë për Administratë dhe Agjencisë për Punësime, në mediumet sociale, si dhe në dy gazeta ditore, nga të cilat në një që botohet në gjuhën maqedonase dhe në një që botohet në gjuhën të cilën e flasin të paktën 20% e përfaqësuesve të komuniteteve. Në thirrjen publike mund të paraqiten kandidatët e interesuar, dhe me aplikimin mund të bashkëngjisin letër motivuese dhe biografi të shkurtër. Është dhënë mundësia, që në thirrjen publike, kandidatë për anëtarë të këshillave drejtues të kenë mundësi të propozojnë organizatat e shoqërisë civile dhe bashkësia e biznesit, ndërsa me aplikimin mund të bashkëngjisin pëlqim me shkrim nga ana e kandidatëve të propozuar, letër motivuese dhe biografi të shkurtër. Për zgjedhjen anëtarë të Këshillit Drejtues dhe Mbikëqyrës në ndërmarrje publike duhet të formohet Komisioni për Seleksionim i përbërë nga kryetari, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre si më poshtë: kryetari dhe zëvendësi i tij, të punësuar te themeluesi, një anëtar dhe zëvendësi i tij, persona që punojnë në seleksionimin e kandidatëve në Agjencinë për Administratë dhe një anëtar dhe zëvendës i tij, persona që punojnë në ndërmarrjen publike. Procedura për seleksionimin e kandidatëve kryetar dhe anëtarë të Këshillit Drejtues përbëhet nga dy faza: seleksionimi administrativ dhe intervista. Seleksionimi administrativ përbëhet nga kontrolli i plotësimit të kushteve të përcaktuara në thirrjen publike, dëshmitë e bashkëngjitura në aplikim dhe vlerësimi i letrës motivuese dhe biografisë së shkurtër. Për kandidatët që gjatë seleksionimit administrativ do të konstatohet se nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në thirrjen publike ose që nuk i

- ▶ kanë depozituar dëshmitë e nevojshme, procedura e seleksionimit përfundon. Numri i përgjithshëm i pikëve për çdo kandidat të paraqitur përcaktohet mbi bazën e pikëve të marra nga letra motivuese dhe biografia e shkurtër në lidhje me kualifikimet profesionale, eksperiencën e punës në fushën përkatëse dhe kompetencat e veçanta. Në intervistë, nëpërmjet pyetjeve për situata të ndryshme, do të kontrollohen kompetencat e përgjithshme të nevojshme për anëtar të Këshillit Drejtues, përkatësisht Këshillit Mbikëqyrës, kurse nëpërmjet pyetjeve profesionale ose detyrave praktike, kontrollohen kompetencat e veçanta të punës nga përshkrimi i vendit të punës. Intervista do të filmohet me kamera. Pas kryerjes së intervistës, në përputhje me pikët e marra nga seleksionimi administrativ dhe intervista, Komisioni do të përgatisë dhe pranë themeluesit do të depozitojë propozim-listën e renditjes së kandidatëve të klasifikuar më mirë për anëtarë të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës, që do të shpallet në ueb-faqen e themeluesit, kurse themeluesi duhet që kandidatët e renditur më mirë t'i emërojë anëtarë të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës. Procedurë identike seleksionimi është parashikuar edhe për drejtorët e ndërmarrjeve publike të themeluara nga komunat, ndërsa ndërmarrjet publike shtetërore do të përfshihen me Ligjin për Shërbimin e Lartë Drejtues.
- Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit vendosen edhe kritere të qarta dhe precize për shkarkimin e anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës. Kështu themeluesi mund të shkarkojë të gjithë anëtarët e këshillave drejtues para skadimit të afatit të

mandatit nëse nuk është i kënaqur nga puna e tyre ose nëse ndërmarrja publike nuk kryen veprimtaritë me interes publik me çmime të përballueshme dhe me cilësi adekuate të shërbimit në vazhdimësi, në mënyrë transparente pa diskriminim të përfituesve të shërbimit, dhe nëse Këshilli Mbikëqyrës nuk ka ndërmarrë asnjë lloj aktiviteti nga kompetencat e tij për tejkalimin e një gjendje të tillë. Themeluesi mund të shkarkojë kryetarin e Këshillit Drejtues në rast se: nuk merr pjesë në seancat e Këshillit Drejtues dy herë radhazi, ose tri herë gjatë dy viteve kalendarike ose nëse konstatohet se në procedurën për emërimin e tij ka paraqitur të dhëna të pavërteta, ose në rast vdekjeje, ose ka humbur aftësinë për punë. Të njëjtat kushte janë parashikuar edhe për shkarkimin e anëtarëve të këshillave mbikëqyrës. Me këtë theksohet në veçanti cilësia e shërbimeve që ndërmarrja publike u ofron qytetarëve si kusht për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës.

4. VLERËSIMI I NDIKIMIT TË RREGULLATIVËS

NDIKIME TË MUNDSHME POZITIVE DHE NEGATIVE TË SECILIT PREJ OPSIONEVE:

4.1 NDIKIME EKONOMIKE

Funksionimi më i mirë i ndërmarrjeve publike duhet të kontribuojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve të cilat ndërmarrja publike u ofron qytetarëve dhe bashkësisë së biznesit. Me përmirësimin e punës së ndërmarrjeve publike do të përmirësohet gjendja e përgjithshme ekonomike në shtet dhe në komunat në të cilat funksionojnë ndërmarrjet publike.

4.2 NDIKIME FISKALE

Duke pasur parasysh faktin se zvogëlohet numri i anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës, dhe në të njëjtën kohë hiqen këshillat mbikëqyrës në ndërmarrjet mikro dhe të vogla do të zvogëlohen edhe shpenzimet për paga të cilat u paguhen këtyre personave. Duke pasur parasysh faktin se nuk ka evidencë të saktë për mjetet financiare që jepen mbi këtë bazë, të cilat në nivel vjetor, arrijnë shumën disa milionë euro, edhe kursimet mbi këtë bazë do të jenë të konsiderueshme. Në mënyrë plotësuese kontrolli më i madh dhe më profesional mbi punën e drejtorëve, veçanërisht nga ana e këshillave mbikëqyrës me siguri do të kontribuojë edhe për shfrytëzimin racional të mjeteve dhe burimeve nga ana e ndërmarrjeve publike.

4.3 NDIKIME SOCIALE

Duke pasur parasysh fakti se ndërmarrjet publike kanë si veprimtari themelore ofrimin e shërbime qytetarëve dhe biznesit, efikasiteti më i madh në menaxhim duhet të çojë në efikasitetin më të madh të vetë ndërmarrjeve publike, dhe me këtë qytetarëve do t'u ofrohen shërbime në mënyrë më efikase. Gjithashtu mundësia që jepet për shkarkimin e anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës nëse ndërmarrja publike nuk kryen veprimtaritë me interes publik dhe nuk jep shërbime publike me çmime të arsyeshme dhe cilësi adekuate shërbimi në vazhdimësi, në mënyrë transparente pa diskriminim të përfituesve të shërbimit, duhet të kontribuojë për përmirësimin shërbimeve publike të cilat ofrojnë ndërmarrjet publike.

4.4 NDIKIME MBI MJEDISIN

Numri më i madh i ndërmarrjeve publike, si veprimtari themelore kanë mirëmbajtjen e higjienës komunale dhe furnizimin me ujë të pijshëm të qytetarëve, efikasiteti më i madh në punën e tyre do të ketë ndikim edhe mbi përmirësimin e mjedisit.

4.5 NDIKIME ADMINISTRATIVE DHE SHPENZIME

a) shpenzime për zbatim

Nuk ka

b) shpenzime për respektimin e rregullativës

Nuk ka

5. KONSULTIME

5.1 PALËT E INTERESUARA DHE MËNYRA E PËRFSHIRJES

Ndryshimet e nevojshme të Ligjit për Ndërmarrjet Publike duhet të jenë në drejtim të përmirësimit të implementimit të tij, pikërisht tejkalimit të të gjitha problemeve të konstatuara deri më tani në praktikë të cilat janë shkak për implementimin e pjesshëm dhe joadekuat të zgjidhjeve ligjore. Ndryshimet e propozuara janë rezultat i një analize gjithëpërfshirëse e cila me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup u bë nga ana e Institutit për Demokraci – Societas Civilis nga Shkupi.

Për konsultimet në lidhje me propozimet u organizuan katër takime konsultative në (1) rajonin Juglindor; (2) rajonin Jugperëndimor; (2) në rajonin e Shkupit.

5.2 PASQYRË E MENDIMEVE TË MARRA DHE TË INTEGRUARA

Propozues	Propozim	Përgjigje
Nikolla Ilijoski – deputet në Kuvendin e RMV-së	Në nenin 2, kriteret janë shumë të larta gjë me të cilën mund të krijohet problem me mos gjetjen e kandidatëve në mjedise më të vogla	Do të lihet hapësirë që të ketë mundësi të mos plotësohen të gjitha kriteret por të paktën një.
	Të zgjerohet me veprimtari të ngjashme, për shembull puna në një NP ka ngjashmëri të madhe me punën e një kompanie ndërtimi	Kërkesa pranohet.
ADKOM	Të mendohet për vlerën e kompensimit të anëtarëve dhe e njëjta të jetë e lidhur me pagën mesatare të ndërmarrjes publike	Kërkesa pranohet.
	Në nenin 17-a, a kanë kapacitet komunitat të formojnë komisione?	Do të përpiqemi të bëjmë një proces i cili nuk do të jetë i ndërlikuar dhe do të përfshijë para së gjithash të punësuarit në seksionet për burime njerëzore në komuna.

	<p>Lista e renditjes të shpallet publikisht, ndërsa nga e gjithë lista këshilli të zgjedhë një listë të shkurtuar</p>	<p>Duhet të shqyrtohet nëse duhet të jetë listë e shkurtuar apo jo.</p>
	<p>Të bëhet ndarja e NP-ve të cilat janë formuar nga ana e Qeverisë së RM-së sepse komunat kanë të ardhurat e tyre</p>	<p>Nuk është në domenin e këtyre propozimeve.</p>
DKSK	<p>Duhet të bisedohet për sferën e veprimit të ligjit, cilat dhe sa NP do të përfshihen, të mendohet për zvogëlimin e numrit</p>	<p>Nuk është në domenin e këtyre propozimeve.</p>
	<p>Për drejtorët dhe Shërbimin e Lartë Drejtues – mendoj që në komuna duhet të gjendet mënyrë e pavarur për zgjedhjen e drejtorëve – përfshirja e këshillit në zgjedhjen e drejtorit do të bëjë që të ketë ndonjë objektivitet /matje të punës së drejtorit</p>	
	<p>Duhet të ekzistojë udhërrëfyes me të cilin do të tregohet përgatitja profesionale e drejtorit</p>	

CUP	Duhet të gjendet mënyrë që të largohet fokusi nga kriteret juridiko-formale dhe të përqendrohet vëmendja te personat të cilët kanë eksperiencë në fushën përkatëse dhe janë të njohur nga bashkësia.	
	Në mjediset e vogla, kriteret e larta formale mund t'i lënë ndërmarjet në gjendje jofunksionale.	

6. KONKLUZIONE DHE ZGJIDHJE E REKOMANDUAR

6.1 PASQYRA KRAHASUESE E NDIKIMEVE POZITIVE DHE NEGATIVE TË ZGJIDHJEVE TË MUNDSHME (OPSIONE)

Të sillet Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike gjë me të cilën do të vendoset procedura sipas meritave për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtorit (ndërmarrje publike komunale), anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës, do të zgjerohen kushtet për shkarkimin e drejtorëve (ndërmarrje publike komunale) dhe për shkarkimin e anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës, do të zvogëlohet numri i këshillave drejtues dhe mbikëqyrës, gjë me të cilën do të përmirësohet puna e përgjithshme e ndërmarrjeve publike.

6.2 RREZIQE NË REALIZIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E SECILËS PREJ ZGJIDHJEVE TË MUNDSHME (OPSIONE)

Rrezik që mund të ndikojë negativisht në realizimin e ligjit është rreziku që të mos ketë kandidatë të mjaftueshëm në thirrjet publike për drejtor, anëtarë të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës të ndërmarrjeve publike.

7. IMPLEMENTIMI I ZGJIDHJES SË REKOMANDUAR

7.1 NEVOJA PËR NDRYSHIMIN E LIGJEVE DHE RREGULLATIVËS NËNLIGJORE NË FUSHËN PËRKATËSE OSE FUSHA TË TJERA TË NGJASHME.

Ligjet që rregullojnë çështje të cilat janë lëndë e rregullimit të këtij ligji, do të përshtaten me dispozitat e këtij ligji më së shumti gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

7.2 AKTE TË NEVOJSHME NËNLIGJORE DHE AFATI PËR SJELLJEN E TYRE

Me ligjin parashikohet sjellja e shumë akteve nënligjore si më poshtë:

- Rregullore për kriteret për përcaktimin e numrit të anëtarëve të Këshillit Drejtues;
- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për shpalljen e thirrjes publike, formën dhe përmbajtjen e thirrjes publike, mënyrën e depozitimit të fletëparaqitjes, mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve dhe pikët e fituara në faza të ndryshme të përzgjedhjes, si dhe çështje të tjera në lidhje me zbatimin e procedurës për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues;
- Korniza e kompetencave për drejtorët e ndërmarrjeve publike dhe
- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për shpalljen e thirrjes publike, formën dhe përmbajtjen e thirrjes publike, mënyrën e depozitimit të fletëparaqitjes, mënyrën e përzgjedhjes ►

- ▶ së kandidatëve dhe pikët e fituara në faza të ndryshme të seleksionimit, si dhe çështje të tjera në lidhje me implementimin e procedurës për zgjedhjen e drejtorit të ndërmarrjes publike.

Të njëjtat të sillen në një afat kohor prej tre muajsh pas sjelljes së ligjit, siç është theksuar në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

7.3 ORGANE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE, ORGANE SHTETËRORE DHE ORGANE TË TJERA KOMPETENTE PËR IMPLEMENTIM:

- Ministria e Ekonomisë, nëpërmjet sjelljes së një pjese të akteve nënligjore dhe mbikëqyrjes mbi zbatimin e këtij ligji;
- Ministri përkatëse për institucionet nga dikasteri përkatës nëpërmjet harmonizimit të ligjeve materiale;
- Themeluesit e ndërmarrjeve publike nëpërmjet implementimit të thirrjeve publike.

8. NDJEKJA DHE VLERËSIMI

8.1 MËNYRA E NDJEKJES SË IMPLEMENTIMIT

Ministria e Ekonomisë do të kryejë mbikëqyrjen mbi implementimin e ligjit.

8.2 VLERËSIMI I EFEKTEVE TË PROPOZIM-LIGJIT DHE AFATET

Vlerësimi i efekteve do të kryhet pas përfundimit të 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

VNR SI NJË
PRAKTIKË
E MIRË
-
LIGJI PËR
NDËRMARRJET
PUBLIKE
-
DHEJTOR, 2019



Проектот е финансиран од Европската Унија

